



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimet e rregullta të paraburgimit të Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) është shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme.¹ Zhvillimet relevante që nga rishikimi i njëmbëdhjetë i paraburgimit të z. Krasniqi më 15 shtator 2023 (“Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin”)² përfshijnë si më poshtë.
2. Më 25 tetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi parashtrimet në lidhje me rishikimin e dymbëdhjetë të paraburgimit të z. Krasniqi (“Parashtrimet e ZPS-së”).³
3. Më 6 nëntor 2023, Mbrojtja e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”) u përgjigj ndaj parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja”).⁴
4. Më 13 nëntor 2023, ZPS-ja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigjja”).⁵

¹ Shih, p.sh., F01110, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin”), 18 nëntor 2022, konfidencial, para. 1-15 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01110/RED).

² F01795, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 15 shtator 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01795/RED).

³ F01886, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 25 tetor 2023.

⁴ F01909, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit* (F01886), 6 nëntor 2023, konfidenciale.

⁵ F01923, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit* (F01886), 13 nëntor 2023, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi.⁶ Ajo argumenton se: (i) në mungesë të ndryshimit të rrethanave që nga Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, mbajtja në paraburgim e z. Krasniqi vazhdon të jetë e domosdoshme dhe e arsyeshme; dhe (ii) ecuria e mëtejshme e gjykimit dhe nxjerrja e materialeve të tjera që i japin z. Krasniqi më shumë informacion lidhur me dëshmitarët e cënueshëm dhe provat kundër tij, mbështesin përfundimin se paraburgimi i tij është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.⁷

6. Mbrojtja e Krasniqit kërkon lirimin e menjëhershëm të z. Krasniqi, me kushte që Trupi Gjykues mund t'i gjykojë të përshtatshme.⁸ Ajo parashtrohet se, në këtë moment, tre vjet pas paraburgimit të tij fillestar, çfarëdo rreziqesh të tjera që Trupi Gjykues ka identifikuar janë të pamjaftueshme për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi.⁹

7. Në Kundërpërgjigje, ZPS-ja parashtrohet se Përgjigjja duhet të hidhet poshtë dhe thekson se z. Krasniqi duhet të mbetet në paraburgim.¹⁰ Ajo argumenton se Përgjigjja mbështetet në masë të tepruar në një numër të kufizuar faktesh të favorshme për Mbrojtjen, qëllimisht keqinterpreton koncepte relevante, dhe përgjithësisht është shqyrtuar dhe hedhur poshtë nga më shumë panele të Dhomave të Specializuara ("DHS").¹¹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore që zbatohen për të vendosur në lidhje me paraburgimin përcaktohen në nenin 41(6), (10), dhe (12) dhe rregullat 56 dhe 57 dhe janë

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 29.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6, 13.

⁸ Përgjigjja, para. 3, 22.

⁹ Përgjigjja, para. 3, 7, 22.

¹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 1, 10.

¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 1.

shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëhershme.¹² Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. RISHIKIMI I RREGULLT I PARABURGIMIT

9. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që të përcaktohet nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtjen në paraburgim.¹³ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, merret parasysh nëse shtrohet para trupit gjykses përkatës, ose *proprio motu*.¹⁴

A. KRITERET E NENIT 41

i. Dyshimi i bazuar

10. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, sipas nenit 41(6)(a) duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhimit të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹⁵

11. ZPS-ja argumenton se, në mungesë të ndonjë ndryshimi të rrethanave që nga vendimi për konfirmimin e Aktakuzës dhe Vendimi i Njëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.¹⁶ Mbrojtja e Krasniqit nuk paraqet parashtrime konkrete në lidhje me këtë pikë.

12. Trupi Gjykses rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se, në bazë të nenit 39(2), ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Krasniqi është penalisht

¹² *Shih, p.sh.*, Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, para. 18-21.

¹³ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA022/F00005/RED).

¹⁴ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA010/F00008/RED).

¹⁵ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7 (me referenca të mëtejshme).

përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁷ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ishte vërtetuar dyshimi i bazuar mirë edhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Krasniqi.¹⁸ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹⁹

13. Në mungesë të ndonjë rrethane të re thelbësore që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se vazhdon të ekzistojë

¹⁷ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar parashtroi aktakuzën e konfirmuar në F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar dhe me më pak redaktime të aktakuzës së konfirmuar, F00647/A01.

¹⁸ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00777/RED) dhe versioni konfidencial me më pak redaktime (F00777/CONF/RED2) u lëshuan, përkatësisht, më 22 prill 2022, 6 maj 2022 dhe 16 maj 2022. Ndryshimet e kërkuara paraqiten hollësisht në paragrafin 11. Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar u dorëzua nga ZPS-ja më 29 prill 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar më tej ("Aktakuza e Konfirmuar"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00999/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03), sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 22 korrik 2022, para. 49(e); F00993, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 24(b); versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00993/RED).

¹⁹ *Shih, p.sh.*, IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED).

dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer vepra penale që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

ii. Domosdoshmëria e paraburgimit

14. Sa u përket arsyeve për vazhdimin e paraburgimit, në nenin 41(6)(b) përcaktohen tri arsye (rreziqe) alternative mbi bazën e të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme.²⁰ Paraburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se do të materializohet një apo më shumë prej këtyre rreziqeve.²¹ Termi “të artikulueshme” në këtë kontekst nënkupton që arsyet duhet të specifikohen në hollësi duke iu referuar informacionit ose provave përkatëse.²² Për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë prej arsyeve sipas nenit 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.²³

a) Rreziku i arratisjes

15. ZPS-ja parashtroi se njohja më e plotë e z. Krasniqi me kuadrin e çështjes, si dhe me akuzat kundër tij dhe provat e paraqitura (ose që do të paraqiten) në lidhje me këto akuza, shton rrezikun që ai të arratiset.²⁴

²⁰ *Krahaso* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, [Judgment](#), 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, [Judgment](#), 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, [Judgment](#), 4 July 2019, para. 155.

²¹ IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED).

²² Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 2022, Ligji nr. 08/L-032, jep këtë përkufizim për termin “i artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

²³ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 22.

²⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

16. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se z. Krasniqi nuk paraqet rrezik arratisjeje dhe se ZPS-ja nuk ka arritur të demonstrojë arsye të artikulueshme në këtë aspekt.²⁵

17. Trupi Gjykues ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së duke mbajtur parasysh fazën aktuale të procesit, dhe pasi nuk ka faktorë relevantë të rinj për t'u marrë parasysh, rikonfirmon konstatimin e vet të mëhershëm se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin e saj për ekzistencën e "mundësisë mjaftueshëm reale"²⁶ që z. Krasniqi do të arratiset në rast se lirohet.²⁷

18. Gjithashtu, sikurse është konstatuar më herët, ka prova se z. Krasniqi ka bashkëpunuar me autoritetet përkatëse në të gjitha fazat gjatë paraburgimit dhe transferimit të tij.²⁸

19. Edhe pse rreziku i arratisjes asnjëherë nuk mund të përjashtohet plotësisht, Trupi Gjykues konstaton se vazhdimi i paraburgimit të z. Krasniqi aktualisht nuk mund të përligjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

b) Rreziku i pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së

20. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të paneleve të ndryshme, ZPS-ja parashtron se z. Krasniqi vazhdon të paraqesë rrezik për pengimin e procesit.²⁹ Sipas ZPS-së, nxjerrja e mëtejshme e informacionit tejet të ndjeshëm Mbrojtjes së Krasniqit dhe zotit Krasniqi vazhdon të rrisë rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun para se dëshmitarët në

²⁵ Përgjigjja, para. 8.

²⁶ *Shih, p.sh.*, Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 24.

²⁷ *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 13.

²⁸ F01212, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Shtatë për Paraburgimin"), 17 janar 2023, konfidencial, para. 18 dhe poshtëshënimi 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01212/RED).

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10-16 (*duke cituar, në veçanti*, Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 21).

fjalë të dëshmojnë.³⁰ Gjithashtu, ZPS-ja pohon se vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes ndaj tyre, gjë që, siç konstatoi Gjykata e Apelit, është një faktor i rëndësishëm kontekstual.³¹

21. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se nuk ekziston mundësia mjaftueshëm reale që z. Krasniqi do ta pengojë procesin.³² Në veçanti, ajo parashtron se nuk ka prova që lidhin atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve me z. Krasniqi dhe vetëm një numër të kufizuar provash konkrete për çfarëdo frikësimi lidhur me këtë proces.³³ Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu pohon se asnjëri nga dëshmitarët e ZPS-së që ka dëshmuar deri më tani nuk ka vërtetuar asnjë pretendim të drejtpërdrejtë kundër z. Krasniqi. Përkundrazi, disa dëshmitarë të ZPS-së kanë dhënë dëshmi për karakterin e mirë të z. Krasniqi.³⁴ Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu nuk pajtohet me pretendimet në lidhje me ndikimin e pretenduar të z. Krasniqi në Kosovë.³⁵ Për më tepër, ajo pretendon se parashtrimet e ZPS-së në mbështetje të rrezikut të pengimit bazohen në një kombinim provash për të cilat është konstatuar se u mungon pesha dhe vlera provuese, dhe në materiale që tani janë pothuajse tri vjet të vjetra.³⁶

22. ZPS-ja kundërpërgjigjet se: (i) argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit në këtë aspekt përgjithësisht përsërisin argumentet që tashmë janë paraqitur dhe Trupi Gjykyes i ka hedhur poshtë.³⁷ Në veçanti, ajo parashtron se: (i) Mbrojtja e Krasniqit minimizon “atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve” që është vërtetuar mirë;³⁸ dhe se (ii) argumenti se dëshmitë e marra nga dëshmitarët e dëgjuar deri më tani nuk mbështesin pretendimin e ZPS-së në lidhje me rrezikun

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-15.

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12 (me referenca të mëtejshme).

³² Përgjigjja, para. 9-16.

³³ Përgjigjja, para. 9-10, 14-16.

³⁴ Përgjigjja, para. 11-12. *Shih gjithashtu Përgjigjen*, para. 2.

³⁵ Përgjigjja, para. 13.

³⁶ Përgjigjja, para. 16.

³⁷ Kundërpërgjigjja, para. 2, 4, 6.

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 3.

e pengimit, i japin peshë çorientuese dhe të tepruar vetëm provave të kryerjes së drejtpërdrejtë.³⁹

23. Trupi Gjykses thekson standardin e përdorur në vlerësimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b), sipas të cilit nuk kërkohet “shembull konkret” për ndonjë rast ku z. Krasniqi ka frikësuar ose ngacmuar personalisht ndonjë dëshmitar.⁴⁰

24. Trup Gjykses më parë ka konstatuar dhe rikonfirmon se ekziston rreziku që z. Krasniqi të pengojë procesin e DHS-së bazuar, ndër të tjera, në: (i) pozitën e tij me ndikim, e cila, marrë së bashku me gatishmërinë dhe aftësinë për të siguruar informacion konfidencial jopublik, çon në përfundimin e arsyeshëm se z. Krasniqi mund të marrë informacion konfidencial për aspekte të cilat aktualisht kanë lidhje me të; (ii) deklaratat e tij publike në të cilat kritikon DHS-në; dhe (iii) përmbajtjen e një postimi në *Facebook* të datës 24 prill 2020 ku vihen në shënjestër “kolaboracionistët”.⁴¹ Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka konfirmuar se: (i) ka tregues se z. Krasniqi ka, më së paku, prirjen për frikësim të dëshmitarëve, për arsytet e përshkruara më parë;⁴² dhe (ii) gjatë vlerësimit nëse ekziston rreziku që z. Krasniqi do të pengojë procesin në rast se lirohet, nuk është e paarsyeshme të merren

³⁹ Kundërpërgjigjja, para. 5.

⁴⁰ *Shih* Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 23, që i referohet IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 59 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA003/F00005/RED).

⁴¹ *Shih, p.sh.*, F00801, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Katërt për Paraburgimin”), 13 maj 2022, konfidencial dhe *ex parte*, para. 48 (versioni i redaktuar konfidencial, F00801/CONF/RED, dhe versioni i redaktuar publik, F00801/RED, u lëshuan, përkatësisht, më 13 dhe 24 maj 2022).

⁴² IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 62 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA002/F00005/RED); IA006/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit”), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED).

parasysh, midis faktorëve të tjerë, deklaratat publike të Krasniqi ku kritikon DHS-në ose postimi në *Facebook* i datës 24 prill 2020.⁴³

25. Siç u vu në dukje më herët, duke pasur parasysh se gjykimi po vazhdon, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm i janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë t'i nxirren Mbrojtjes së Krasniqit,⁴⁴ dhe, rrjedhimisht, do t'u bëhen të njohura një rrethi më të gjerë personash, përfshirë z. Krasniqi. Trupi Gjykues rithekson se kjo, nga ana tjetër, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi. Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm do të ishte në kundërshtim me mbrojtjen efektive të dëshmitarëve që ende nuk kanë dëshmuar.⁴⁵

26. Gjithashtu, sa u përket argumenteve të Mbrojtjes së Krasniqit që kundërshtojnë provat e ZPS-së për atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve,⁴⁶ ka pak rëndësi fakti që disa dëshmitarë të ZPS-së mund të kenë diskutuar këtë proces me publikun. Më e rëndësishmja, kjo nuk është në kundërshtim me konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykues se është duke e shqyrtuar këtë aspekt duke pasur parasysh informacionin se në Kosovë vazhdon

⁴³ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 50.

⁴⁴ *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 20; F01679, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin"), 17 korrik 2023, para. 26 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 9 gusht 2023, F01679/RED); F01530, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Nëntë për Paraburgimin"), 17 maj 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 22 maj 2023, F01530/RED), para. 22; F01382, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Tetë për Paraburgimin"), 17 mars 2023, para. 25 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 20 mars 2023, F01382/RED).

⁴⁵ *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 20; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 26; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 22; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 25.

⁴⁶ Përgjigja, para. 14-15.

të ekzistojë një atmosferë e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në lidhje me këtë çështje dhe çështje të tjera gjyqësore para DHS-së.⁴⁷

27. Duke mbajtur parasysh konstatimet e mësipërme, argumentet përkatëse të Mbrojtjes së Krasniqit hidhen poshtë.⁴⁸

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Krasniqi do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, në rast se lirohet.

c) Rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme

29. Duke iu referuar konstatimeve të Trupit Gjykses në Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, ZPS-ja parashton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë vepra penale të mëtejshme.⁴⁹ Sipas ZPS-së, konstatimi i Trupit Gjykses se nxjerrja në vijimësi e informacionit të ndjeshëm paraqet rrezik të papranueshëm të kryerjes së veprave penale të mëtejshme, bëhet edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh ecurinë në vazhdimësi të procesit.⁵⁰ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se duhet të merret parasysh natyra shumë e rëndë e akuzave kundër z. Krasniqi.⁵¹

30. Mbrojtja e Krasniqit parashton se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e një rreziku mjaftueshëm real se z. Krasniqi do të kryejë vepra penale të mëtejshme.⁵² Në veçanti, ajo pretendon se argumentet e ZPS-së në mbështetje të rrezikut të kryerjes së veprave penale të mëtejshme bazohen në një

⁴⁷ *Shih* Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 27; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 23; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 26, që i referohet KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Trupi Gjykses I, *Versioni i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit*, 24 janar 2023, para. 57.

⁴⁸ Përgjigja, para. 9-16.

⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-20 (ku citohet, në veçanti, Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 25).

⁵⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 20.

⁵¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18.

⁵² Përgjigja, para. 17. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 2.

kombinim provash për të cilat është konstatuar se u mungon pesha dhe vlera provuese, dhe në materiale që tani janë pothuajse tri vjet të vjetra.⁵³

31. Parashtrimet e ZPS-së në Kundërpërgjigje sa i përket rrezikut të kryerjes së veprave penale të mëtejshme janë përgjithësisht identike me ato të përmbledhura në paragrafin 22 më lart në lidhje me rrezikun e pengimit.

32. Trupi Gjykses rikujton konstatimin në Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë vepra penale të mëtejshme.⁵⁴ Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit janë relevantë për analizimin e rrezikut që z. Krasniqi të kryejë vepra penale të mëtejshme.⁵⁵ Duke pasur parasysh këta faktorë, Trupi Gjykses gjykon se nuk janë krijuar rrethana të reja që nga rishikimi i fundit i paraburgimit që do të përligjin konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

33. Trupi Gjykses thekson faktin se gjykimi po vazhdon, se identitetet e dëshmitarëve të ndjeshëm vazhdojnë t'i nxirren Mbrojtjes së Krasniqit, dhe se duhet të parandalohet çdo rrezik i kryerjes së veprave penale të mëtejshme.

34. Trupi Gjykses gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Krasniqi do të kryejë vepra penale të mëtejshme sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

iii. Përfundim

35. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se aktualisht nuk ka informacion të mjaftueshëm që të përligjë konstatimin se z. Krasniqi mund t'i ikë drejtësisë. Sidoqoftë, bazuar në standardin përkatës, Trupi Gjykses është bindur se ekziston rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe rreziku që ai të

⁵³ Përgjigja, para. 16.

⁵⁴ Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

⁵⁵ Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

kryejë vepra penale të mëtejshme kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykses do të vlerësojë më poshtë nëse kushtet për lirimin e tij i trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rrezeqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

36. Duke iu referuar konstatimeve të mëhershme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se: (i) rrezeqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) mund të menaxhohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së; (ii) nuk ka ndodhur asgjë që nga Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin që do të përligjte vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore; dhe (iii) përkundrazi, vazhdimi i gjykimit dhe nxjerrja e mëtejshme e provave i shtojnë më shumë se kurrë këto rrezeqe.⁵⁶

37. Mbrojtja e Krasniqit ia lë Trupit Gjykses të vendosë se cilat kushte konsiderohen të përshtatshme.⁵⁷

38. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh masat alternative për parandalimin e rrezeqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵⁸ Në nenin 41(12) përcaktohen disa faktorë për t'u marrë parasysh në mënyrë që të sigurohet prania e të akuzuarit në gjykim, të parandalohet kryerja e veprave penale të mëtejshme

⁵⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21-25 (që i referohen Vendimit të Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29-31).

⁵⁷ Përgjigjja, para. 3, 22.

⁵⁸ Sa i përket detyrimit për të marrë parasysh "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova*, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, *Judgment*, 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

dhe të garantohet kryerja me sukses e procesit. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ekzistojnë masa alternative më të buta dhe logjike të disponueshme të cilat do të mund të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat alternative të arsyeshme që mund të zbatohen dhe jo vetëm ato që propozon Mbrojtja e Krasniqit apo ZPS-ja.⁶⁰

39. Sa i përket rrezikut të pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme, Trupi Gjykses ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se:

- a) në këtë fazë të procesit, asnjë prej kushteve të propozuara më herët nga Mbrojtja e Krasniqit dhe as ndonjë masë shtesë sipas nenit 41(12), e urdhëruar *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese në lidhje me z. Krasniqi;⁶¹
- b) masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, marrë në tërësi: (i) ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me synimin e zvogëlimit të rrezikut të pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme; dhe (ii) ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku shkeljet e mundshme të konfidencialitetit mund të evidentohen dhe/ose parandalohen më lehtë;⁶² dhe

⁵⁹ Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. *Shih gjithashtu ECtHR, Idalov v. Russia [GC]*, para. 140 *in fine*.

⁶⁰ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 86; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

⁶¹ *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 38. *Shih gjithashtu* IA020/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 2 gusht 2022, konfidencial, para. 39 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA020/F00005/RED).

⁶² *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 38. *Shih gjithashtu* IA016/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi*

- c) komunikimet e z. Krasniqi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁶³

40. Trupi Gjykses vazhdon të jetë i mendimit se asnjë masë shtesë e përcaktuar në nenin 41(12), e urdhëruar *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojë rreziqet sa i përket z. Krasniqi në këtë fazë të procesit dhe në shkallë që mund të krahasohet me paraburgimin në objektin e paraburgimit të DHS-së.

41. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është ende i bindur për përfundimet e nxjerra më parë, të përmbledhura në paragrafin 39 më lart, dhe konstaton se rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme mund të menaxhohen në mënyrë efektive në këtë fazë të procesit vetëm nëse z. Krasniqi vazhdon të mbahet në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka alternativa ndaj vazhdimin të paraburgimit të z. Krasniqi që mund të parandalojnë rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii), qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore.

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

42. ZPS-ja argumenton se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, paraburgimi i z. Krasniqi vazhdon të jetë proporcional.⁶⁴ Në këtë aspekt, ZPS-ja i referohet konstatimit të mëparshëm të Trupit Gjykses se: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm; (ii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim

Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit ("Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 25 mars 2022, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA016/F00005/RED).

⁶³ *Shih* Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 34; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 39.

⁶⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26-28.

të gjatë; (iii) rreziqet ende të pranishme sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me zbatimin e masave alternative të arsyeshme; (iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse; (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve, siç përshkruhet më lart; dhe (vi) në këtë çështje gjyqësore po vazhdohet të bëhet përparim.⁶⁵

43. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se vazhdimi i paraburgimit të z. Krasniqi nuk është proporcional.⁶⁶ Ajo në veçanti parashtrohet se pasojat për familjen e tij dhe jetën familjare kanë qenë dhe do të jenë tepër të mëdha, sidomos pasi që z. Krasniqi nuk është i pranishëm në momente kyçe të jetës së anëtarëve të familjes dhe pasi që lirimi për arsye humanitare nuk është alternativë e realizueshme.⁶⁷ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit parashtrohet se Trupi Gjyqësor duhet të marrë parasysh kohën që z. Krasniqi ka kaluar tashmë në paraburgim, ecurinë e ngadaltë të gjyqimit deri më tani, dhe, në lidhje me këtë, të drejtën e z. Krasniqi për t'u gjykuar brenda një periudhe të arsyeshme, sipas nenit 21(4)(d).⁶⁸

44. ZPS-ja kundërpërgjigjet se pretendimi i Mbrojtjes së Krasniqit se gjykimi po zhvillohet "shumë më ngadalë" se që pritej është i mjegullt dhe përgjithësisht i pabazuar.⁶⁹ Ajo gjithashtu parashtrohet se ky pretendim nuk merr parasysh disa faktorë të rëndësishëm, si: (i) vëllimi i konsiderueshëm i provave shtesë të pranuar si prova jогоjore dhe sipas rregullave 153 dhe 155; (ii) dëshmitë e gjata ose komplekse të disa dëshmitarëve; (iii) orari i planifikuar i seancave; dhe (iv) mundësitë për thjeshtimin e paraqitjes së provave që ka dhe përdor ZPS-ja për të shkurtuar kohëzgjatjen e seancave në të ardhmen.⁷⁰ Gjithashtu, sipas ZPS-së, pretendimi se paraburgimi deri në fund të gjyqimit nuk është proporcional është

⁶⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁶⁶ Përgjigja, para. 18-21.

⁶⁷ Përgjigja, para. 2, 19-20.

⁶⁸ Përgjigja, para. 18, 21.

⁶⁹ Kundërpërgjigja, para. 7.

⁷⁰ Kundërpërgjigja, para. 7.

i parakohshëm dhe shpërfill ndjeshmërinë e shprehur në mënyrë të përsëritur të Trupit Gjykses për këtë pikë.⁷¹

45. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive specifike të saj në kohën kur bëhet vlerësimi.⁷² Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, ndër veçoritë e kësaj çështjeje gjyqësore përfshihen si vijon: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare, në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm;⁷³ (ii) në rast se shpallet fajtor, z. Krasniqi mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) rreziqet ende të pranishme sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me zbatimin e masave alternative të arsyeshme;⁷⁴ (iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse;⁷⁵ (v) atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve e përshkruar më lart; dhe (vi) fakti që gjykimi është në zhvillim e sipër.

46. Trupi Gjykses është i mendimit se, në këtë fazë, këta faktorë peshojnë më shumë se çfarëdo ndërhyrje në të drejtën e z. Krasniqi për jetë familjare⁷⁶ si rezultat i pamundësisë së tij për të marrë pjesë në aktivitete familjare. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vë në dukje se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se: (i) fakti që të paraburgosurit janë të ndarë prej familjeve të tyre, dhe të larguar për njëfarë distance prej tyre, është pasojë e

⁷¹ Kundërpërgjigjja, para. 8.

⁷² Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 33; Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin, para. 53; Vendimi i Nëntë për Paraburgimin, para. 37; Vendimi i Tetë për Paraburgimin, para. 42; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 43.

⁷³ F00999/A01, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar*, 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 10-12, 32, 39-40, 44, 49, 53, 55-57, 176-177 (versioni publik me më pak redakte u dorëzua më 27 shkurt 2023, F01323/A01).

⁷⁴ *Shih më lart*, para. 38-41.

⁷⁵ *Shih, p.sh.*, Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, para. 59; Vendimin e Pestë për Paraburgimin, para. 58; Vendimin e Katërt për Paraburgimin, para. 81.

⁷⁶ *Shih* nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

pashmangshme e burgosjes së tyre;⁷⁷ dhe (ii) paraburgimi nënkupton kufizime të vetvetishme në jetën private dhe familjare të një të paraburgosuri.⁷⁸ Është e qartë nga kjo jurisprudencë se këto kufizime në vetvete nuk përbëjnë shkelje të së drejtës së të paraburgosurit për jetë familjare dhe private. GJEDNJ-ja theksoi në këtë kontekst rëndësinë për t'i mundësuar të paraburgosurit të mbajë kontaktet me familjen, në veçanti përmes vizitave familjare në objektin e paraburgimit.⁷⁹ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton se vizitat familjare në objektin e paraburgimit të DHS-së lejohen shprehimisht me kornizën ligjore të DHS-së.⁸⁰ Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit në këtë aspekt.

47. Sa u përket parashtrimeve të Mbrojtjes së Krasniqit në lidhje me ecurinë e ngadaltë të gjykimit,⁸¹ Trupi Gjykses vë në dukje me shqetësim vonesat e shkaktuara si nga ZPS-ja ashtu edhe nga Mbrojtja, të cilat kanë kontribuar në humbjen e kohës së çmuar të gjykimit deri më tani.⁸² Trupi Gjykses gjithashtu ka bërë me dije se mund të detyrohet të marrë masa në lidhje me këtë.⁸³ Gjithsesi, është e parakohshme në këtë moment të nxirret ndonjë përfundim se ecuria e gjykimit shkel të drejtën e z. Krasniqi për t'u gjykuar brenda një periudhe të arsyeshme, sikurse mishërohet në nenin 21(4)(d).

48. Duke pasur parasysh sa më lart, dhe në veçanti faktorët e përmendur në paragrafin 45 më lart, Trupi Gjykses konstaton se paraburgimi i z. Krasniqi për

⁷⁷ *Shih, midis shumë të tjerash*, ECtHR, *Rodzevillo v. Ukraine*, no. 38771/05, [Judgment](#), 14 January 2016, para. 83; *Vintman v. Ukraine*, no. 28403/05, [Judgment](#), 23 October 2014, para. 78 (të dy me referenca të mëtejshme).

⁷⁸ *Shih, p.sh.*, ECtHR, *Khoroshenko v. Russia* [GC], no. 41418/04, [Judgment](#) ("*Khoroshenko v. Russia*"), 30 June 2015, para. 106 (me referenca të mëtejshme).

⁷⁹ *Shih p.sh.* ECtHR, [Khoroshenko v. Russia](#), para. 106, 123 (me referenca të mëtejshme).

⁸⁰ *Shih, në veçanti*, KSC-BD-09/Rev1/2020, *Udhëzues Pune i Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit: Vizitat dhe Komunikimet*, 23 shtator 2020, nenet 10-15, 24; KSC-BD-33, *Udhëzim i Njësisë së Paraburgimit: Procedurat e Vizitave nga Anëtarë të Familjes dhe Vizitorë të tjerë Personalë*, 23 shtator 2020, Kreu IV dhe Shtojca A.

⁸¹ Përgjigjja, para. 21.

⁸² Transkripti i seancës, 30 tetor 2023 ("*Transkripti i Datës 30 Tetor 2023*"), konfidencial, f. 9239, rreshti 20, deri në f. 32940, rreshti 23 (*Shih, në veçanti*, f. 9239, rreshtat 20-23).

⁸³ Transkripti i Datës 30 Tetor 2023, f. 9240, rreshtat 18-23.

edhe dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat specifike të kësaj çështjeje gjyqësore.

49. Megjithatë, Trupi Gjykes thekson se z. Krasniqi tashmë ndodhet në paraburgim për një kohë të konsiderueshme, dhe se gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore ka shumë të ngjarë të zgjasë. Sikurse është vënë në dukje më herët,⁸⁴ kjo kërkon që si Trupi Gjykes ashtu edhe palët të mbajnë veçanërisht parasysh nevojën që të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykes do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. KLASIFIKIMI

50. Duke vënë në dukje se përgjigjja është dorëzuar si konfidenciale, Trupi Gjykes urdhëron Mbrojtjen e Krasniqit që të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes deri **të mërkurën, 22 nëntor 2023**.

51. Duke vënë në dukje se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Kundërpërgjigjes si publike dhe duke pasur parasysh se Kundërpërgjigjja nuk përmban informacion konfidencial, Trupi Gjykes urdhëron Zyrën Administrative që ta riklasifikojë Kundërpërgjigjen si publike.

VI. RISHIKIMI I ARDHSHËM I PARABURGIMIT

52. Duke pasur parasysh afrimin e pushimit dimëror të gjykatës, Trupi Gjykes e gjykon të përshtatshme të shkurtojë afatin e zakonshëm për dorëzimin e parashtrimeve sipas rregullës 76, për t'iu përmbajtur afatit për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Krasniqi. Trupi Gjykes urdhëron ZPS-në, në pajtim me rregullën 9(5)(a), të dorëzojë parashtrime deri në orën 16:00 të premtën,

⁸⁴ *Shih, p.sh.*, Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 35; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 56; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 44; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 46.

22 dhjetor 2023, dhe Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojë përgjigjen, nëse do të ketë, deri në orën 16:00 të enjten, 4 janar 2024. ZPS-ja duhet të dorëzojë kundërpërgjigjen, nëse do të ketë, deri në orën 16:00 të enjten, 9 janar 2024.

VII. VENDIM

53. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes deri **të mërkurën, 22 nëntor 2023**;
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Kundërpërgjigjen (F01923) si publike; dhe
- d) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Krasniqi, deri të **premtën, 22 dhjetor 2023 (deri në orën 16:00)**, që përgjigjja, nëse do të ketë, të dorëzohet deri **të enjten, 4 janar 2024 (deri në orën 16:00)**, dhe kundërpërgjigjja, nëse do të ketë, deri **të martën, 9 janar 2024 (deri në orën 16:00)**.

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 15 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.